



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET**

P/ VENDIM

**PËR MIRATIMIN TË NDËRTIMIT QËNDRËS BURIMORE PËR GRUMBULLIMIN DHE
PËRPUNIMIN E MBETJEVE TË RICIKLUESHME, PËRMET**

Këshilli Bashkiak Përmet mbledhur më dt. ___/___/2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 dt. 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligjit nr. 10 463, datë 22.9. 2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" i ndryshuar me ligjin nr. 156, datë 10.10.2013, , Vendimit nr. 418, datë 27.5.2020 "Për Miratimin e dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035". VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim" Ligjit nr.107/2014 datë 01/10/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, si dhe relacionin e paraqitur nga grupi i menaxhimit të mbetjeve, pas diskutimeve

VENDOSI:

1. Të miratojë ngritjen e Qendrës Burimore për rikuperimin e mbetjeve të riciklueshme, sipas projekt-preventivit të paraqitur, dhe është është pjesë përbërëse e tij.
2. Vëndi i ndërtimit të kësaj qendre do të jetë ish "Ndërrmarja rruga-ura" pronë e Bashkisë Përmet.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISË
Alma HOXHA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Njësia Bashkiake e Menaxhimit të Mbetjeve

RELACION

PËR MIRATIMIN E VËNDIT TË NDËRTIMIT QËNDRËS BURIMORE PËR
GRUMBULLIMIN DHE PËRPUNIMIN E MBETJEVE TË RICIKLUESHME

Të nderuar Këshilltarë

Hyrje

Strategjia Kombëtare e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e ka përcaktuar drejtimin e politikës së Qeverisë së Shqipërisë për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve, duke synuar minimizimin e impaktit të mbetjeve në mjedis në nivelin kombëtar dhe lokal si dhe përmirësimin e përdorimit eficient të burimeve në Shqipëri. Kjo strategji është krijuar duke u mbështetur në angazhimin financiar të Qeverisë Shqiptare për të transformuar statusin e vendit në lidhje me reduktimin e mbetjeve, riciklimin, kompostimin apo përpunimin me përfitim energjie. Ajo ka vendosur objektiva sfidues dhe realiste njëkohësisht, të cilët synojnë mundësimin e ndryshimit rrënjësor të mënyrës së menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri.

Niveli Vendor. Ligji Nr.139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore përcakton përgjegjësitë dhe autoritetin e NJQV-ve në lidhje me menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë, grumbullimi, transportimi dhe asgjësimi, si edhe trajtimi i mbetjeve bashkiake përcaktohet si funksion i bashkive. Sipas këtij përkufizimi, bashkitë kanë të drejtën dhe përgjegjësinë e menaxhimit të ofrimit të shërbimit në një mënyrë që i përshtatet më së miri kushteve të tyre specifike. Detyrat e veçanta të menaxhimit të mbetjeve për bashkitë dhe këshillat rajonale janë të përcaktuara në ligjin Nr. 10463/2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, i ndryshuar, dhe në disa akte nënligjore që rrjedhin nga ky ligj. Instrumentet e planifikimit në nivel vendor përfshijnë planet vendore të menaxhimit të mbetjeve, të cilat duhet të jenë në harmoni me planet përkatëse kombëtare dhe rajonale të menaxhimit të mbetjeve. Në nivel vendor, shërbimet e MMN ose zbatohen nga bashkitë me personelin dhe me pajisjet e tyre ose nga kontraktorë privatë

Riciklimi. Sipas përbërjes së mbetjeve, afërsisht një e treta e mbetjeve të prodhuara në Shqipëri është potencialisht e riciklueshme. Përqindjet më të mëdha të mbetjeve të riciklueshme janë mbetjet plastike, letra dhe kartonët. Siç është përmendur tashmë, Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve si dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve, sigurojnë një bazë themelore për zbatimin e parashikuar të aktiviteteve të riciklimit. Gjithashtu Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve i miratuar në përputhje me Direktivën e Mbetjeve dhe në fund me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM nr. 177, datë 06.03.2012) “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” vendosin objektivat dhe rregullat e riciklimit dhe rikuperimit të mbetjeve nga ambalazhet.

Megjithëse rregulloret shqiptare detyrojnë bashkitë të fillojnë grumbullimin e diferencuar në tre fraksione të ndryshme (materiale të riciklueshme të thata, mbetje organike për kompostim dhe mbetje

fundore), deri më tani ka një përfshirje shumë të kufizuar të bashkive në lidhje me riciklimin dhe kompostimin. Për sa i përket ndarjes në burim nga familjet ose bizneset, janë paraqitur shumë pak nisma zyrtare. Në fakt, deri më tani bashkitë nuk kanë përmbyshur detyrat e tyre për arsye të ndryshme duke përfshirë kapacitete dhe burime të pamjaftueshme financiare, të ardhura të pamjaftueshme, mungesë përvoja dhe pamundësi për të krijuar skema të grumbullimit të diferencuar apo për zbatimin e kërkesave ligjore. Për më tepër, autoritetet vendore kanë mungesë të ekspertëve mjedisorë të specializuar për çështjet e mbetjeve.

Të dhëna të përgjithëshme rreth projektit.

Bazuar ne Marreveshjen e Bashkepunimit midis Bashkise Permet dhe Projektit te GIZ (BE per Ekonomine Qarkulluese dhe Ekonomia Qarkulluese per Zhvillimin Urban te Qendrueshem), eshte vendosur qe gjate vitit 2024 ne Bashkine Permet te ngrihet nje Qender burimore per rikuperimin e mbetjeve te riciklueshme te thata dhe te grumbulluara nepermjet nje skeme te vecante te grumbullimit te mbetjeve te riciklueshme ne burim. Bashkia Përmet ka propozuar një vend nen administimin e saj per ngritjen e Qendres Burimore, që ndodhet 1 km nga qendra e qytetit. Ky vend, eshte përdorur më parë për qëllime industriale para vitit 1990. Qendra Burimore do te financohet nga Projekti ne bashkepunim me Bashkine Permet. Gjithashtu do te organizohet nje skeme e mbyllur, e paisur me infrastrukturen e nevojshme si kosha rrjete per grumbullimin e diferencuar te plastikes si dhe koshat rrjete per grumbullimin e kartonit dhe letres. Shperndarja e tyre do te jete kryesisht ne sheshet publike dhe qendra recreative per depozitimin e plastikene dhe ne marketet e supermarketet per grumbullimin e kartonit. Gjithashtu ne skeme do te perfshihen edhe shkolla e mesme dhe 9-vjecare duke i paisur me infrastrukturen perkatese. Gjithashtu ne sherbim te grumbullimit te mbetjeve te riciklueshme do te vihet ne dispozicion nje mjet per grumbullimit dhe transportimin per ne QB nje mjet teknologjik miqësor me mjedisin (eco – friendly). Si fillim me ngritjen e qendres dhe funksionimin e skemes se grumbullim – transportim – perpunim, parashikohet grumbullimi dhe perpunimi i rreth 30 % te materialit riciklues (plastike + karton e leter + metale te buta), afersisht 90 – 100 ton. Ne vitet e ardhme do te shikohet nje opsion te rritjes se sasise se grumbullimit e perpunimit te mbetjeve ricikluese deri ne 50 %, si dhe inisiativave rajonale per nje trajtim rajonal te mbetjeve te riciklueshme. Infrastruktura e skemes se grumbullimit e perpunimit te materialeve (mbetjeve) te riciklueshme do te jene si fillim ngritja e Qendres Burimore ku do te punesohen mes 2 punonjes (per grumbullimin e presimin e materialit riciklues), do te vendoset nje beiler (prese) per perpunimin e materialeve ricikluese, shperndarja e **8 koshave rrjete per shise plastike** e kanoce alumini (3 kosha ne shetitore + 3 kosha ne zona recreative + 2 kosha ne shkolla), shperndarja e **15 kosha rrjete per grumbullimin e kartonit dhe letres** (ne markete e supermarket si dhe shkolla) si dhe venia ne dispozicion e nje mjete elektrik dhe më vonë të bicikletave elektrike per grumbullimin e materialeve ne pikat e caktuara dhe në prespektivë edhe dere me dere (door to door collection).


Zona ku do te ngrihet qendra burimore

Objekti ndodhet jashtë qytetit të Përmetit dhe ndodhet me koordinata (40°14'28.30"n, - 20°21'24.68"). Eshte lehtesisht i aksesueshem pasi ka prane infrastruktures rrugore, energji elektrike, ujesjelles kanalizime ekzistuese ne gjendje te mire dhe te rinovuar vitet e fundit. Vëndi ku ndodhet objekti dhe objektet janë në pronësi të Bashkisë Përmet. Kjo zonë gjatë viteve 80-90 ka qenë një zonë industriale, ndërkohë që aktualisht zona është e populluar.


Pozicioni horografik i qëndrës



Planvendosje e Qëndrës



Planimetria



Pamje 3D e qëndrës



Të dhëna teknike mbi ndërtimin e kësaj qëndre

Godina do te jete me konstrukcion metalik dhe panele sanduic, kjo per shkak te reduktimit te kostos, rritjes se jetgjatesise se objektit, rritjes se efciences energjitike te objektit si dhe shpejtesise se montimit.

Godina do të ketë karakter industrial dhe do të perdoret për magazinim. Zona përreth ka një popullim të ndërtesave industriale dhe të shërbimit, ku edhe tentojmë që t'i ofrojmë një infrastrukturë sa më moderne dhe komode të gjithë zones. Hapësirat dhe koncepti janë parashikuar për t'i shërbyer më së miri funksionit kryesor të kërkuar. Pozicionimi i objektit është bërë duke ruajtur distancat sipas rregullores, pasojë kjo e terrenit të mjaftueshëm dhe në parashikim të ligjit përkatës për të ruajtur ambjentin rrethues

Vlera totale e ndërtimit të qëndrës është parashikuar **5,432 992** Lekë me TVSH.

Vlera e financimit nga projekti GIZ është **5 308 625** Lek ose 98 % të investimit. (*zerat sipas preventivit*)

Bashkia do të jetë bashkëfinancuese në vlerën **124 366** leke ose rreth 2% të këtij investimi dhe mer për sipër punimet elektrike.

Aspekti ligjor dhe institucional.

Në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të menaxhimit të mbetjeve, si dhe në kuadër të Planit Rajonal për menaxhimin e mbetjeve në ZMM Gjirokastër – Vlora Jug, si pjesë e projektit EU4RËM të inicjuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe kontributin e BE dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim (AFD) pjesë e së cilës është edhe Bashkia e Përmetit, është parashikuar ndërtimi i një Stacioni Transferimi (ST) për dy Bashkitë (Përmet-Këlcyrë). Ndërtimi i këtij ST i cili shpresojmë se do të realizohet shumë shpejt, do bëjë të mundur mbylljen e vënd-depozitimit aktual në Piskovë, i cili theksojmë se është i përkohshëm.

Bashkia Përmet në kuadër të projektit “Bashki të Forta”, projekt i Agjencisë Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim SDC, zbatuar nga Helvetas ka hartuar Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMIMNU) 2024-2029, i cili është miratuar me VKB Përmet **nr.42 date 07.06.2024**, si një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel lokal, si një dokument/ udhëzues i rëndësishëm për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Përmet. Gjithashtu me VKB **nr.75 date 31.10.2022** është miratuar Rregullorja për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane në Bashkinë Përmet.

Riciklimi në vetvete është ndoshta elementi më thelbësor dhe forma më e njohur për zvogëlimin e mbetjeve që zhvillohet nëpërmjet një zinxhiri procesesh, duke përfshirë ndarjen në burim, grumbullimin e diferencuar, përzgjedhjen dhe përpunimin, që çon në zvogëlimin e një sasive të konsiderueshme të mbetjeve që depozitohen në lëndfill

Terma të përgjithshme.

Referuar VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"

III. PËRKUFIZIME

a) “*Mbetje të riciklueshme të thata*”, një grup mbetjesh ku përfshihen rrymat e mbetjeve: letër/karton, metal, plastikë, qelq, materialet e të cilave, nëpërmjet çdo operacioni rikuperimi, ripërpunohen për t'u shndërruar në produkte, materiale apo substanca për t'u përdorur si për qëllimin fillestar, ashtu edhe për qëllime të tjera.

b) “*Mbetje të pariciklueshme*”, një grup mbetjesh të parrezikshme të cilat nuk mund të rikuperohen, të ripërdoren dhe të ripërpunohen për t'u shndërruar në produkte, materiale apo substanca për t'u përdorur si për qëllimin fillestar, ashtu edhe për qëllime të tjera.

c) “*Mbetje të riciklueshme të njoma*”, një grup mbetjesh, ku përfshihen rrymat e mbetjeve të frutave dhe perimeve të pagatuara, mbetjet e biodegradueshme të gjeneruara nga kopshtet, si bar ose kërcëj lulesh, bimë dhe degë pemësh, mbetjet nga krasitjet etj.

ç) “*Njësi e qeverisjes vendore*” ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

d) “*Optimizim*”, gjetja e alternativave me koston më efektive dhe performancën më të lartë në

grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.

VI. BASHKËPUNIMI NDËRMJET AUTORITETEVE

Me qëllim arritjen e objektivave të parashikuar në pikën 1 të ndarjes V, njësitë e qeverisjes vendore bashkëpunojnë në kuadër të rrjetit të integruar të instalimeve, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, për të bërë të mundur grumbullimin maksimal të diferencuar të mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin ose depozitimin në një prej instalimeve më të afërta, të përshtatshme me metodat dhe teknologjitë e nevojshme, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë mjedisor dhe të mbrojtjes së shëndetit publik.

KREU IV I VKM

5. Njësitë e qeverisjes vendore marrin masat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim, duke u siguruar qytetarëve minimalisht një sistem grumbullimi mbetjesh prej tri grupesh për:

- a) mbetje të riciklueshme të thata;
- b) mbetje të riciklueshme të njoma;
- c) mbetje të pariciklueshme.

V. OBJEKTIVAT PËR RIPËRDORIMIN DHE RICIKLIMIN E RRYMAVE TË MBETJEVE

1. Objektivat specifikë, që duhet të arrihen nga njësitë e qeverisjes vendore për ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve sipas peshës, duhet të jenë, si më poshtë vijon:

- a) Letër/karton (60%);
- b) Metal (50%);
- c) Plastikë (22.5%);
- ç) Qelq (60%).

2. Objektivat e ndërmjetëm duhet të parashikohen nga njësitë e qeverisjes vendore në planet e tyre të menaxhimit në përputhje me nevojat lokale dhe mundësitë aktuale. Objektivat e përcaktuar në pikën 1 janë të detyrueshëm për t’u arritur nga njësitë e qeverisjes vendore të çdo niveli.

3. Në planet vendore të menaxhimit të mbetjeve, të cilat duhet të hartohen në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve, duhet të parashikohen masa e metoda për arritjen e objektivave brenda afateve të vendosura.

Përfitimet nga ndërtimi dhe funksionimi i kësaj qëndre

- 1) Realizimi i objektivave të vendosura në kuadrin ligjor për menaxhimin e mbetjeve urbane, për të cilat Bashkia ka detyrim.
- 2) Reduktimi i mbetjeve të grumbulluara në PGM.
- 3) Ulja e kostos së transportit të tyre aktualisht në vëndepozitimin e Piskovës dhe me vonë në ST. Përfundimtar.
- 4) Përmirësimi i ndjeshëm i territorit të qytetit, natyrës së tij, si dhe mbingarkimi i kontenierëve në PGM.
- 5) Përfitimet financiare nga shitja e këtyre produkteve tek operatorët ekonomik privat.
- 6) Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve në lidhje me ndarjen në burim të mbetjeve si fillim (letër/karton +plastikë) dhe në prespektivë për grumbullimin e diferencuar të rrymave të mbetjeve për të reduktuar sasinë e mbetjeve që do të depozitohen në ST përfundimtar

Njësia Bashkiake për menaxhimin e mbetjeve në ZMM Gjirokaster.

Përbërja:

- 1) Marsela **KAPLLANI** (*Përgjegjëse e Urbanistikës dhe Planifikimi të territorit*)
- 2) Arian **JAUPI** (*Specialist i Shërbimeve Publike*)
- 3) Adriatik **BAKUSHI** (*Specialist Hartograf, Zyra e urbanistikes*)